



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dorezuar Prilidhena / Prilidhena Received / Delivery	22.12.2022	2	viti god year
Organ / Rjeshtja Organ / Rjeshtja Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	8366/2022		112



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.981/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.981/2022 të datës 08.11.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.12.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.981/2022 të datës 08.11.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Komunën e Mitrovicës, më datë 08.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 6884/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për njohje të së drejtës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5). Ndërsa, i njëjti me datë 22.12.2022 ka parashtruar kërkesën me numër protokollit 8300/2022, me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.981/2022 të datës 08.11.2022.

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës për tërheqje të ankesës, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.981/2022 të datës 08.11.2022.



Kështu që duke u bazuar në nenin 6 pangari 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.981/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

